



VENDIM

Nr. 193, Datë 22.12.2016

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI UNIVERSAL PËR KATEGORINË KLIENT – OBJEKTE KULTI/BASHKËSI FETARE

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërma “c” dhe 109 pika 5, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorive Teknike,

Konstatoi se:

- Njëpërmjet Shkresës nr 390, prot datë 29.09.2016, Komiteti Shtetëror për Kultet ka parashtruar kërkesën mbi mundësinë e ndryshimit të tarifës së energjisë elektrike për bashkësitë fetare.
- Kjo kërkesë ka gjetur mbështetjen e Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese njëpërmjet shkresës nr. 3791 prot, datë 16.12.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të filloj procedurat për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi Universal për kategorinë Klient – Objekte Kulti/ Bashkësi Fetare.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.